



MANUAL

I PJESËMARRJES SË PUBLIKUT
NË PROCESIN VENDIMMARRËS
TË KUVENDIT



MANUAL

I PJESEMARRJES SË PUBLIKUT NË PROCESIN VENDIMMARRËS TË KUVENDIT

“Miratuar nga Byroja e Kuvendit me Vendim Nr. 17, Datë 11.11.2014”

■ Qëllimi i manualit

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë sanksionon parimet e shtetit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Një nga këto të drejta është dhe ajo e organizimit kolektivisht, për çfarëdo qëllimi të ligjshëm, e cila i garanton individit pjesëmarrjen aktive në shoqëri. Garantimi i kësaj të drejte u siguron individëve pjesëmarrjen në proceset vendimmarrëse në të gjitha nivelet. Pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje është element thelbësor për çdo sistem politik transparent, të përgjegjshëm dhe demokratik. Pjesëmarrja e publikut në procesin vendimmarrës të Kuvendit të Shqipërisë, i sjell individët më afër qeverisjes duke u krijuar mundësinë që të adresojnë problemet dhe të ofrojnë zgjidhje të përshtatshme për to; të vlerësojnë rezultatet e zbatimit të politikave, të mbikëqyrjes së veprimtarisë së të zgjedhurve të tyre për t'i bërë ata më të përgjegjshëm, etj. Shumë prej këtyre individëve janë gjithashtu edhe zgjedhës, gjë që thekson marrëdhënien me demokracinë përfaqësuese.

Manuali i pjesëmarrjes së publikut në procesin vendimmarrës të Kuvendit është një burim për të nxitur dhe siguruar pjesëmarrjen e shoqërisë civile në funksionin legjislativ dhe atë mbikëqyrës të Kuvendit të Shqipërisë. Pjesëmarrja, sidomos e shoqërisë civile në procesin ligjvënës të Kuvendit i shërben përmirësimit të cilësisë së legjislacionit të shqyrtuar dhe miratuar. Ajo merr rëndësi të veçantë kur diskutohen çështje që kanë të bëjnë me grupe në nevojë si personat me aftësi të kufizuara, gratë, fëmijët, minoritetet, etj. Ky manual, synon t'i japë mundësinë publikut që, që nga qytetari më i thjeshtë e deri tek organizatat jofitimprurëse të shndërrohen në pjesëmarrës aktivë të zhvillimit të komunitetit ku bëjnë pjesë dhe në ofrues të përmirësimit të politikave ligjore, nga të cilat preken.

Në këtë manual, pjesëmarrja e publikut është trajtuar në kuptim të: Informimit, konsultimit, dialogut dhe partneritetit.

Informimi

E drejta për informim është baza e përfshirjes së publikut në procesin ligjvënës dhe të kontrollit të zbatimit të legjislacionit. Kjo e drejtë garantohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Kodi i Procedurave Administrative dhe ligji për të drejtën e informimit për dokumente zyrtare. Informimi konsiston në ofrimin e njëanshëm të informacionit nga Kuvendi i Shqipërisë pa qenë nevoja për ndërveprim apo përfshirje të subjektit kërkues të informacionit.

Konsultimi

Kjo është ajo formë e bashkëpunimit, ku organet e Kuvendit u kërkojnë përfaqësuesve të shoqërisë civile mendimin e tyre për një projektligj apo rreth një çështjeje të caktuar. Nisma dhe tema e konsultimit del nga organet e Kuvendit.

Dialogu

Nisma për dialog mund të merret si nga organet e Kuvendit, ashtu edhe nga përfaqësuesit e shoqërisë civile. Dialogu siguron shkëmbimin e pikëpamjeve për një çështje të caktuar apo gjatë shqyrtimit të një projektligji.

Partneriteti

Partneriteti përfshin përgjegjësi të përbashkëta në çdo hap të procesit të vendimmarrjes politike, dhe është forma më e ngushtë e bashkëpunimit me shoqërinë civile.

Manuali synon që të jetë një instrument interaktiv, i dobishëm dhe udhërrëfyes si për publikun ashtu edhe për deputetët e administratën e Kuvendit, për të siguruar pjesëmarrjen e vazhdueshme dhe sistematike të publikut në procesin vendimmarrës.

■ Përkufizime

Në këtë manual, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

“Ekspert” është personi me dije dhe aftësi të veçanta në një fushë të caktuar.

“Shoqëri civile” sipas përkufizimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara janë **organizatat vullnetare** të qytetarëve, të cilat kanë si qëllim përparimin e ideve, interesave dhe ideologjive të tyre. Në këtë kuptim shoqëria civile njehsohet me organizatat jofitimprurëse.

“Organizata jofitimprurëse” janë shoqatat, fondacionet dhe qendrat, veprimtaria e të cilave zhvillohet në mënyrë të pavarur dhe pa u ndikuar nga shteti, të cilat veprojnë sipas legjislacionit në fuqi për organizatat jofitimprurëse. Organizatat jofitimprurëse, në kuptim të këtij manuali, përfaqësojnë interesat e një grupi personash fizikë ose juridikë.

“Koalicione”, janë grupimi i disa organizatave jofitimprurëse, që kanë qëllime të përbashkëta dhe bashkohen për të bashkërenduar veprimet në një fushë të caktuar.

“Grupe interesi” janë subjekte fizike ose juridike, të prekura nga një projektligj apo të interesuara për një çështje të caktuar, përfshirë këtu dhe organizatat e punëmarrësve ose të biznesit.

“Grupime të tjera të interesuara” janë grupimet e individëve, të cilët kanë interes të drejtpërdrejtë për një çështje të vetme, në një moment të caktuar.

■ Kur lejohet pjesëmarrja e publikut në procesin e vendimmarrjes

Veprimtaria e Kuvendit është e hapur, me përjashtim të rasteve kur Kuvendi vendos ndryshe, në kushtet e përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë.

Bashkëpunimi i organeve të Kuvendit me publikun zhvillohet për çështje që kanë të bëjnë me kontrollin e zbatimit të legjislacionit në fuqi, gjatë shqyrtimit të projektligjeve, apo për çështje që lidhen me veprimtarinë e Kuvendit me karakter edukues, promovues, shkencor, etj.

Bashkëpunimi me publikun nuk zhvillohet gjatë procesit të vendimmarrjes që lidhet me çështjet e sigurisë kombëtare, për aq sa ato përbëjnë sekret shtetëror, sipas ligjit për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”; marrëdhëniet ndërkombëtare dhe marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe si dhe vendimet e Kuvendit.

■ Palët e interesuara

Palët e interesuara në kuptim të këtij manuali ndahen në:

- **Palët e interesuara nga autoritete publike**, të cilët janë anëtarë apo përfaqësues të Këshillit të Ministrave, si dhe përfaqësues të lartë të institucioneve shtetërore ose publike. Në përcaktimin e palëve të interesuara nga autoritete publike dhe informacionit të kërkuar prej tyre, nga organet e Kuvendit, mbahet parasysh parimi kushtetues i ndarjes së pushteteve.

- **Palët e interesuara nga publiku** janë individë, ekspertë, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të grupeve të interesit, si dhe grupime të tjera të interesuara. Këto mund të jenë përfaqësuesit e qytetarëve (përfshirë edhe fëmijët e shoqëruar nga të rriturit), të cilët janë të prekur nga një ligj apo politikë e caktuar; organizatat e shoqërisë civile; ekspertë të pavarur; ekspertë të organizatave të shoqërisë civile; organizata të punëmarrësve; shoqata të bizneseve apo shoqata të ndryshme profesionale; etj.

Shembuj të organizatave të shoqërisë civile janë organizatat jofitimprurëse, të cilat mund të kenë si mision të tyre edukimin qytetar, apo ato lloj organizatash misioni i të cilave mund të përmblihet si i lidhur me çështje të zhvillimit të demokracisë dhe qeverisjes; organizata avokuese që përfaqësojnë grupe të cënueshme të shoqërisë, si për shembull organizata të grave, apo të personave me aftësi të kufizuara, të pakicave kombëtare, të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve etj.; organizata që ofrojnë shërbime të ndryshme, si shërbime këshillimi për gratë e dhunuara, apo për të varfrit, moshën e tretë, etj., si dhe çdo organizatë tjetër që vepron në përputhje me legjislacionin në fuqi për OJF-të.

■ Parimet e pjesëmarrjes së publikut

Parimet e pjesëmarrjes së publikut në procesin vendimmarrës të Kuvendit janë:

Transparenca

Veprimtaria e Kuvendit është e hapur. Pjesëmarrja e publikut në vendimmarrjen e Kuvendit kërkon përgjegjshmëri, qartësi në dhënie dhe një informacioni të aksesueshëm dhe të mjaftueshëm, besim e respekt të ndërsjellë si dhe llogaridhënie nga të dy palët, me një transparencë në të gjitha fazat, bazuar në legjislacionin në fuqi.

Nxitja e pjesëmarrjes së publikut

Nxitja e pjesëmarrjes së publikut në procesin e kontrollit të zbatimit të legjislacionit në fuqi dhe atë ligjvënës të Kuvendit, synon të promovojë në mënyrë të qëndrueshme, shkëmbimin e informacionit dhe eksperiencës, përmirësimin e legjislacionit si dhe të rrisë besimin e publikut tek Kuvendi dhe administrata e tij. Me qëllim që të jetë efektive, pjesëmarrja e publikut në procesin ligjvënës të Kuvendit mundësohet në kohën e duhur, atëherë kur vendimmarrja nuk është realizuar ende. Kuvendi nuk mbështet pjesëmarrjen e publikut, kur ajo mund të krijojë ose dyshohet se krijon kushte për konflikt interesi ose korrupsion. Në nxitjen e pjesëmarrjes së publikut në procesin e kontrollit të zbatimit të legjislacionit dhe atë ligjvënës, Kuvendi i Shqipërisë angazhohet të bazohet në legjislacionin në fuqi dhe në praktikat më të mira ndërkombëtare.

Mosdiskriminimi

Veprimtaria e Kuvendit dhe organeve të tij, në qasjen për pjesëmarrjen e publikut, bazohet në dhënie dhe mundësi të barabartë për pjesëmarrje për të gjithë, pas asnjë lloj diskriminimi. Përfaqësuesit e publikut kanë të drejtën e veprimit të pavarur dhe advokimit për qëndrime të ndryshme nga ato të organeve të Kuvendit.

■ Publikimi i projektligjeve e kalendarit të punimeve të Kuvendit dhe komisioneve parlamentare

Veprimtaria e hapur dhe transparente e Kuvendit realizohet nëpërmjet:

- a) pjesëmarrjes së publikut në procesin ligjvënës;
- b) pasqyrimin të veprimtarisë së Kuvendit dhe organeve të tij në mediane shkruar dhe vizive;
- c) botimeve të dokumentacionit parlamentar;
- ç) faqes së internetit të Kuvendit;
- d) rrjetit të brendshëm audiovizual.

Faqja e internetit e Kuvendit, për procedurën ligjvënëse, në mënyrë të përditësuar përmban:

- tekstin e projektligjeve të depozituara, së bashku me relacionin shoqërues të tyre;
- kalendarin e punës së komisioneve të përhershme dhe ecurinë e shqyrtimit të projektligjeve;
- tekstin e amendamenteve të depozituara në komisione dhe të amendamenteve të miratuara prej tyre;
- raportet e komisioneve parlamentare, të cilat shqyrtojnë projektligjin;
- procesverbalet e mbledhjeve të Konferencës së Kryetarëve, të komisioneve dhe të këshillave;
- procesverbalet e seancave plenare.

○ Ku mund të gjendet informacioni mbi projektligjet dhe kalendarin e punimeve?

Projektligjet dhe Kalendarin e punimeve të Kuvendit dhe i komisioneve parlamentare publikohen në faqen zyrtare të internetit të Kuvendit të Shqipërisë, www.parlament.al.

Projektligjet me relacionin shoqërues publikohen menjëherë pas njoftimit në seancë plenare dhe gjenden duke klikuar në menunë kryesore, tek **“Dokumente Parlamentare”**. Me vendosjen e kursorit tek **“Projektligje”**, shfaqen dhe informacioni se e kujt nismë është një projektligj.




Programi i punës së Kuvendit dhe Kalendari tre javor i punimeve publikohet pas miratimit me mirëkuptim në Konferencën e Kryetarëve, ose pas miratimit me shumicë votash në seancë plenare. Ato mund të gjenden duke klikuar në menunë kryesore, tek **“Kuvendi në Seancë Plenare”**. Në kategoritë që ju shfaqen, nëse klikoni tek **“Programi i Punës”**, apo tek **“Kalendari i Punimeve”** do të merrni gjithë informacionin që ju dëshironi për këto kategori. Programi i punës dhe kalendari i punimeve gjenden po ashtu të publikuara si rubrika në “home page” të faqes zyrtare të internetit. Mjafton të klikoni ...



Kuvendi i Shqipërisë publikon në faqen zyrtare të tij në internet procesverbalet e mbledhjeve të Konferencës së Kryetarëve dhe të këshillave, pas nënshkrimit nga Kryetari i Kuvendit, procesverbalet e seancave plenare pas miratimit në seancën e radhës dhe procesverbalet e komisioneve pas miratimit në komision.

○ **Ku mund të konsultohen procesverbalet?**

Procesverbalet e mbledhjes së Konferencës së Kryetarëve dhe të këshillave, si dhe ato të seancave plenare dhe të komisioneve gjenden duke klikuar në rubrikën **“Dokumente Parlamentare”**. Në kategoritë që shfaqen është dhe **“Procesverbale”** me legjislaturën e specifikuar. Me vendosjen e kursorit në këtë kategori, ju prezantohet një listë e veprimtarisë parlamentare, procesverbalin e së cilës ju kërkoni. Nëse klikoni në një prej tyre, ju shfaqen të kategorizuara procesverbalet që i përkasin kësaj veprimtarie.



Kuvendi i Shqipërisë publikon në faqen zyrtare të tij në internet edhe këto materiale:

- a. tekstin e amendamenteve të depozituara në komisione dhe të amendamenteve të miratuara prej tyre;
- b. raportet e komisioneve parlamentare, të cilat shqyrtojnë projektligjin;
- c. ligjet e miratuara, pas shpalljes nga Presidenti i Republikës;
- d. si dhe çdo material tjetër që konsiderohet i nevojshëm për transparencën parlamentare.

○ **Ku mund të merret informacioni mbi rendin e ditës së punës në komisione dhe në seancë plenare?**

Rendi i ditës për seancat plenare dhe për veprimtarinë në komisione publikohet “home page”, tek rubrika “*Sot në Kuvend*”, po ashtu dhe tek “*Veprimtari*”, kategoria “*Rendi i Ditës*”.



○ **Sistemi Info Point**

Të interesuarit mbi punimet e Kuvendit të Shqipërisë dhe vizitorët në mjediset e Kryesisë së Kuvendit dhe në Sallën e Seancave Plenare kanë mundësinë të marrin një informacion elektronik të shpejtë e mjaft të dobishëm, orientues, të përditësuar e transparent përmes dy pikave të informimit Info Point të vendosura respektivisht në këto ambiente. Ky sistem informativ përmban ndër të tjera informacionet kryesore mbi vendin, orën, rendin e ditës së punimeve në seancë plenare, komisione parlamentare, por dhe sa i përket veprimtarive të tjera parlamentare.

○ **Pasqyrimi i veprimtarisë së Kuvendit dhe organeve të tij në media**

Kuvendi i Shqipërisë gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tij udhëhiqet nga parimi i garantimit të së drejtës së informimit. Të drejtën e akreditimit e gëzojnë të gjitha mediet audiovizive, të shkruara dhe elektronike, shqiptare dhe të huaja si dhe punonjësit e medias në profesion të lirë.

Të drejtën e transmetimit e gëzojnë të gjitha mediet audiovizive.

Televizioni Publik Shqiptar transmeton të plotë seancën plenare në të cilën diskutohet:

- miratimi i programit politik dhe i përbërjes së Këshillit të Ministrave;
- seancat e pyetjeve;
- seancë e përjavshme e pyetje-përgjigjeve;
- interpelancat;
- interpelancat urgjente;
- mocionet;
- mocionet e besimit dhe të mosbesimit;
- raportet e komisioneve hetimore;
- nismat për rishikim të Kushtetutës.

Televizioni Publik Shqiptar transmeton në orët e shikimit më të shumtë edhe seanca të tjera plenare, për të cilat Kuvendi vlerëson se duhet bërë transmetimi i tyre i plotë.

○ **Pasqyrimi i veprimtarisë në seancë plenare**

Seancat plenare të Kuvendit, si rregull, bëhen të hapura. Kuvendi, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij, mund të vendosë që mbledhjet, ose pjesë të tyre të bëhen të mbyllura. Kur vendoset zhvillimi i mbledhjes me dyer të mbyllura, personat e akredituar largohen nga salla me kërkesë të drejtuesit të seancës.

○ **Pasqyrimi i veprimtarisë së komisioneve parlamentare**

Mbledhjet e komisioneve të përhershme dhe nënkomisioneve të Kuvendit, si rregull, bëhen të hapura. Komisionet e përhershme dhe nënkomisionet, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve, mund të vendosin që mbledhjet ose pjesë të tyre të bëhen të mbyllura. Kur vendoset zhvillimi i mbledhjes me dyer të mbyllura, personat e akredituar largohen nga salla me kërkesë të drejtuesit të mbledhjes.

Rregullat procedurale të parashikuara për komisionet e përhershme të Kuvendit zbatohen edhe për Komisionet e posaçme, si dhe për Komisionet Hetimore.

Njoftimet për të veprimtarinë e përditshme të Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë dhe të Kuvendit të Shqipërisë, publikohen në faqen zyrtare të internetit, www.parlament.al, në rubrikën “Aktualitet”.

■ Koordinatorit për grupet e interesit

Koordinatori për grupet e interesit është personi përgjegjës, në administratën e Kuvendit, për koordinimin e marrëdhënieve dhe lehtësimin e praktikave të bashkëpunimit mes Kuvendit dhe grupeve të interesit, shoqërisë civile dhe partnerëve socialë.

Detyrat kryesore të Koordinatorit për grupet e interesit janë:

- a. Të informoje grupet e interesit, shoqërinë civile dhe partnerët socialë për projektligjet që do të shqyrtohen dhe diskutohen në Komisionet e Përhershme Parlamentare.
- b. Të kontaktojë me grupet e interesit për tërheqjen e mendimit me shkrim për projektligjet që shqyrtohen dhe diskutohen në Komisionet Parlamentare.
- c. T'i përcjellë në kohë stafit të komisioneve të përhershme parlamentare, mendimet dhe sugjerimet e grupeve të interesit, shoqërisë civile dhe partnerëve socialë.
- ç. Të njoftojë në kohë grupet e interesit, shoqërinë civile dhe partnerët socialë, për pjesëmarrjen e tyre në mbledhjet e komisioneve parlamentare, kur kjo të çmohet e arsyeshme nga drejtuesit e komisionit parlamentar.
- d. Të informojë grupet e interesit, shoqërinë civile dhe partnerët socialë për ligjet e miratuara dhe marrjen në konsideratë ose jo të sugjerimeve të tyre dhe arsyetimin në rastin e fundit.

■ Regjistri elektronik i shoqërisë civile

Kuvendi i Shqipërisë, gjatë aktivitetit të tij, ka vlerësuar gjithmonë si të domosdoshëm dhe me përparësi, konsultimin me organizatat e shoqërisë civile. Për këtë qëllim, shërben dhe Regjistri elektronik i Shoqërisë Civile (informacioni i këtij regjistri është depozituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, sipas Sistemit të Integruar Tatimor, ku të gjitha organizatat e shoqërisë civile janë aktive).

Ky regjistër, është një element kyç për identifikimin e këtyre organizatave, si dhe shërben si mjet lidhës e komunikues me Kuvendin e Shqipërisë.

■ Seancat dëgjimore publike

Rregullorja e Kuvendit në nenin 36 të saj, përcakton se:

“1. Komisioni mund të organizojë seanca dëgjimore publike me anëtarë të Këshillit të Ministrave, përfaqësues të lartë të institucioneve shtetërore ose publike, ekspertë, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të grupeve të interesit, si dhe grupime të tjera të interesuara. Komisioni është i detyruar të realizojë seancën dëgjimore, sipas përcaktimeve të bëra në këtë nen, në rast se një e treta e të gjithë anëtarëve të Komisionit e kërkon atë në mënyrë të motivuar me shkrim.

1/1. Gjatë procesit legjislativ, Komisioni mund të organizojë seanca dëgjimore publike, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 1 të këtij neni. Komisioni nuk mund të përgatisë raportin për seancë plenare pa u realizuar seanca dëgjimore.

2. Në përgatitjen e seancës dëgjimore publike, kryetari, në bashkëpunim me zëvendëskryetarin dhe sekretarin e Komisionit, i paraqet të ftuarve çështjet për të cilat kërkohet informacion.”

Seanca dëgjimore publike është mekanizimi me anë të cilit çdo komision parlamentar, brenda fushës së vet të përgjegjësisë, merr informacion nga anëtarë të Këshillit të Ministrave, përfaqësues të lartë të institucioneve shtetërore ose publike, ekspertë, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të grupeve të interesit, si dhe grupime të tjera të interesuara.

Seancat dëgjimore publike zhvillohen:

- a) për të marrë informacion për çështje që lidhen me kontrollin e zbatimit të legjislacionit në një fushë të caktuar;
- b) gjatë procesit të shqyrtimit të një projektligji (gjatë procesit legjislativ).

Zhvillimi i seancave dëgjimore është i rëndësishëm për:

✓ *Shkëmbimin e informacionit*

Deputetët dhe publiku përfitojnë nga procesi i shkëmbimit të informacionit. Seanca dëgjimore publike i lejon deputetëve t'i paraqesin publikut nismat ligjore në mënyrë formale dhe të organizuar. Ata kanë mundësi gjithashtu, të marrin informacion të vlefshëm nga të gjitha palët e interesuara, për formulimin e politikave alternative, gjatë diskutimit për efektivitetin e një ligji në fuqi apo shqyrtimit të një projektligji. Informacioni që kanë palët e interesuara vjen në formën e eksperiencave të personave, që janë prekur nga zbatimi në praktikë i një ligji të miratuar apo që preken nga përcaktimet e një projektligji. Informacioni i paraqitur para deputetëve i krijon mundësinë palëve të interesuara, të marrin pjesë në shqyrtimin e legjislacionit në mënyrë aktive dhe njëkohësisht i bën ato më të përgjegjshme për të vëzhguar politikatat legjislative që i prekin.

✓ *Legjitimitetin*

Përfshirja e publikut në zhvillimin e një procesi me bazë shkëmbimin e informacionit dhe opinionëve, pavarësisht nëse këto opinione në përfundim do të merren parasysh apo jo, i jep legjitimitet procesit ligjvënës.

✓ *Të dhënat apo njohuritë alternative*

Gjatë zhvillimit të një seance dëgjimore, politika e zbatuar nga një ligj i miratuar, apo e propozuar nëpërmjet një projektligji, shihet nga këndvështrime të ndryshme: nga njëra anë është informacioni i atyre që e kanë hartuar atë ,ndërsa nga ana tjetër është informacioni i atyre që do të preken prej saj. Informacioni i sjellë nga palët e interesuara përbëhet nga vlera dhe njohuri lokale që shpesh ekspertët i “injorojnë” gjatë procesit të hartimit të një projektligji, me synimin për të qenë sa

më përfshirës dhe përgjithësues në normat e hartuara. Organizatat e shoqërisë civile kanë si objekt të punës së tyre krijimin dhe promovimin e një morie vlerash në dobi të shoqërisë dhe ato, në më të shumtën e rasteve kanë zhvilluar dhe përparuar profilizimin e tyre në një fushë të caktuar, aq sa, përmes ekspertizës së tyre mund të japin alternativa të vlefshme për t'u shqyrtuar nga komisionet parlamentare. Mund të jetë edhe rasti kur, opinionet e palëve të interesuara megjithëse janë dhënë, nuk janë marrë parasysh prej grupit hartues të projektligjit në fazën e konsultimit dhe dëgjimi në komisionet parlamentare është një shans i dytë për propozimet alternative. Dëgjimi i dy perceptimeve dhe interpretimeve të ndryshme i jep mundësinë deputetëve të vlerësojnë impaktin e legjislacionit të zbatuar ose të propozuar dhe për rrjedhojë ata marrin vendime më të mira.

✓ *Fuqizimin e përfshirjes së publikut*

Fuqizimi i përfshirjes së publikut, në procesin kontrollit të zbatimit të legjislacionit dhe sidomos në procesin ligjvënës, është qëllimi qendror i këtij manuali. Seancat dëgjimore publike janë mekanizmi për të fuqizuar përfshirjen e publikut në kuptim të konsultimit dhe dialogut. Fuqizimi i pjesëmarrjes së publikut në veprimtarinë e Kuvendit rrit llogaridhënien dhe transparencën e aktivitetit të deputetëve në përfaqësimin e interesave të zgjedhësve të tyre.

✓ *Besimin*

Zhvillimi i seancave dëgjimore krijon dhe rrit besimin e publikut tek institucioni i Kuvendit si institucion përfaqësues, dhe tek deputetët në veçanti. Zhvillimi i seancave dëgjimore i jep mundësi publikut të vlerësojë vullnetin dhe aftësinë e deputetëve për të dëgjuar zërin e atyre që përfaqësojnë.

✓ *Ofrimin e zgjidhjeve*

Seancat dëgjimore publike, shpesh janë tryezat ku zhvillohen debatet mes përfaqësuesve të qeverisë dhe palëve të interesuara, për çështje të përmbajtjes së një projektligji, apo edhe për çështje të zbatimit të një ligji. Ato shërbejnë për zgjidhjen e tensioneve të krijuara si dhe për dhënien e zgjidhjeve të pranuar nga të gjitha palët.

✓ *Kulturën e pjesëmarrjes*

Seancat dëgjimore publike ndihmojnë në transformimin nga kulturë teknokratike dhe politike të shqyrtimit të një çështjeje, në një kulturë dialogu të hapur dhe bashkëpunimi mes palëve të interesuara dhe Kuvendit. Zhvillimi i kësaj kulture siguron shërbime dhe ekspertiza profesionale të dhëna nga organizatat e shoqërisë civile, përmes partneritetit dhe ndërtimit të besimit të ndërsjellë, dhe më e rëndësishmja, pa kosto buxhetore.

Çdo komision i përhershëm parlamentar zhvillon veprimtarinë në bazë të programit të punës dhe kalendarit të punimeve të tij. Ata hartohen duke mbajtur parasysh programin e punës dhe kalendarin e punimeve të Kuvendit dhe në mënyrë që raporti i Komisionit për shqyrtimin e projektligjit t'i paraqitet Kuvendit jo më vonë se 2 ditë para zhvillimit të seancës plenare. Kryetari i Komisionit, në këshillim me zëvendëskryetarin dhe sekretarin e Komisionit, i propozon për miratim Komisionit programin e punës dhe kalendarin e punimeve të tij. Praktikisht, gjatë procesit të hartimit të kalendarit trijavor, Kryesia e Komisionit vlerëson mundësinë e zhvillimit të një seance dëgjimore publike, e cila mund të ketë si objekt marrjen e informacionit për çështje që lidhen me kontrollin e zbatimit të legjislacionit në një fushë të caktuar ose marrjen e mendimeve dhe rekomandimeve gjatë shqyrtimit të një projektligji. Kalendarin e punimeve i bëhet i njohur anëtarëve të Komisionit, dhe në mbledhjen e zhvilluar për diskutimin e tij, edhe çdo deputet mund t'i propozojë Komisionit zhvillimin e një seance dëgjimore publike. Komisioni merr vendim me votim të hapur për kalendarin e punimeve të tij. Në rast se Kryesia e Komisionit nuk bie dakord, paraprakisht, për zhvillimin e një seance dëgjimore publike, pavarësisht objektit të saj, dhe në mbledhjen e Komisionit për diskutimin e kalendarit, propozimi nuk merret parasysh, atëherë një e treta e të gjithë anëtarëve të Komisionit e kërkon zhvillimin e saj, në mënyrë të motivuar me shkrim. Komisioni është i detyruar të realizojë seancën dëgjimore, të kërkuar sipas kësaj procedure.

Seancat dëgjimore publike për të marrë informacion për çështje që lidhen me kontrollin e

zbatimit të legjislationit në një fushë të caktuar, mund të zhvillohen në çdo kohë që Komisioni e çmon të arsyeshme.

Rregullorja e Kuvendit përcakton se gjatë procesit legjislativ, Komisioni mund të organizojë seanca dëgjimore publike. Komisioni nuk mund të përgatisë raportin për seancë plenare pa u realizuar seanca dëgjimore. Rregullorja e Kuvendit ka njohur rëndësinë e seancës dëgjimore gjatë procesit legjislativ, pasi moszhvillimi i saj, (jemi në kushtet kur ka një kërkesë nga një e treta e të gjithë anëtarëve të Komisionit dhe Komisioni ka detyrimin ta realizojë seancën dëgjimore) bllokoi kalimin për shqyrtim të projektligjit në seancë plenare. Njëkohësisht, nëpërmjet këtij përcaktimi, rregullorja, në mënyrë të tërthortë ka përcaktuar edhe kohën kur duhet të zhvillohet ajo. Kështu, seanca dëgjimore nuk mund të zhvillohet pas miratimit në tërësi të projektligjit. Në mënyrë që Komisionit të ketë mundësi të vlerësojë rekomandimet e dhëna nga palët e interesuara, dhe që seanca dëgjimore të jetë efektive, ajo duhet realizuar pas shqyrtimit në parim të projektligjit dhe para shqyrtimit të tij nen për nen, në komision. Ky është një rregull përgjithësisht i zbatueshëm nga çdo komision, gjatë shqyrtimit të projektligjeve.

Në varësi të objektit të seancës dëgjimore, Komisioni mund të kërkojë nga të ftuarit informacione për studime apo analiza të politikave të caktuara, analiza financiare, përfshirë vlerësime të ndikimit financiar të projektligjeve; studime në monitorimin e zbatimit të ligjeve; analiza ligjore të çështjeve të caktuara; propozime për përmirësime konkrete të një projektligji, etj.

Komisioni fton të marrin pjesë në seancat dëgjimore publike anëtarë të Këshillit të Ministrave, përfaqësues të lartë të institucioneve shtetërore ose publike, ekspertë, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të grupeve të interesit, si dhe grupime të tjera të interesuara (*shih paragrafin e përkufizimeve*). Në disa prej komisioneve, është bërë praktikë që Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi të jenë të ftuar sa herë që shqyrtohen çështje që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut.

Identifikimi i palëve të duhura për t'u konsultuar është thelbësor, pasi gjatë një seance dëgjimore me një kohëzgjatje të zakonshme prej dy deri tri orësh, Komisioni mund të dëgjojë vetëm një numër të kufizuar personash. Prandaj kryesitë e komisioneve janë të kujdesshme që të përzgjidhen ato palë të interesuara nga publiku, që preken drejtpërdrejt nga një ligj ose projektligj, apo ato që kanë ekspertizë sektoriale për të vlerësuar cilësinë e tij. Identifikimi i palëve të interesuara është një sfidë për praktikën aktuale të konsultimit që përdoret nga Kuvendi, në kushtet e një shoqërie civile tepër të zhvilluar në numër dhe cilësi.

Në përgatitjen e listës së palëve të interesuara nga publiku (*shih paragrafin Palët e interesuara*) Komisioni mund:

- të konsultohet me regjistrin e Kuvendit për organizatat e shoqërisë civile dhe të vendosë të përzgjedhë nga lista që i ofrohet nga koordinatori për marrëdhëniet me shoqërinë civile në Kuvend;
- të përzgjedhë nga baza e të dhënave të shoqërisë civile, grupeve të interesit apo grupimeve të tjera të interesuara, të mbajtur nga stafi i Komisionit. Stafi i Komisionit kujdeset për përditësimin e kësaj baze të dhënash, në bashkëpunim edhe me koordinatorin për shoqërinë civile në Kuvend;
- të vendosë të ftojë organizatat që i propozohen nga Kryesia apo deputetët e Komisionit;
- të vendosë duke kombinuar mundësitë e mësipërme.

Në rastin kur seanca dëgjimore është kërkuar në mënyrë të motivuar me shkrim nga një e treta e të gjithë anëtarëve të Komisionit, Komisioni thërret organizatat e përcaktuara në kërkesën e deputetëve. Në rast se deputetët nuk kanë përcaktuar në kërkesë, në mënyrë nominative subjektet që do të ftohen, atëherë Komisionit vendos sipas mënyrave të përshkruara më sipër.

Pas identifikimit të të ftuarve potencialë, Kryetari i Komisionit udhëzon stafin për t'i ftuar ata të marrin pjesë në seancën dëgjimore publike.

Zhvillimi i seancës dëgjimore i nënshtrohet rregullave të përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit, për shqyrtimin e çështjeve në komisione. Kryetari i Komisionit u jep fjalën të gjithë të ftuarve brenda kohës së caktuar për diskutim (zakonisht deri në 10 minuta), sipas radhës së vendosur prej tij për

diskutimet.

Nëse të ftuarve u janë kërkuar, paraprakisht, të sjellin materiale me shkrim, atëherë stafi i Komisionit kujdeset që deputetët t'i kenë materialet të paktën një ditë përpara zhvillimit të seancës dëgjimore. Rekomandimet për ndryshime në një projektligj, duhet të jenë të referuara saktë në nenin që propozohet të ndryshohet dhe të jenë të shkruara sipas rregullave të teknikës legjislative.

Nëse të ftuarit diskutimet e tyre për çështjen i kanë përgatitur edhe me shkrim, një kopje e tyre i vihet në dispozicion sekretarisë së Komisionit, e cila më pas ia shpërndan deputetëve.

Procesverbali i seancës dëgjimore, publikohet në faqen zyrtare të internetit të Kuvendit dhe sekretaria e Komisionit ia dërgon atë të ftuarve pjesëmarrës në seancën dëgjimore, brenda 2 ditëve nga zbardhja e tij. Gjithashtu, palët e interesuara mund ta gjejnë atë të publikuar në faqen zyrtare të internetit të Kuvendit (*shih paragrafin Ku mund të konsultohen procesverbalet?*).

Pas zhvillimit të seancës dëgjimore publike për të marrë informacion për çështje që lidhen me kontrollin e zbatimit të legjislacionit në një fushë të caktuar, Komisioni mund të vendosë t'u dërgojë rekomandime institucioneve përgjegjëse për çështjen e zbatimit të legjislacionit apo për përmirësim të tij. Këto rekomandime u dërgohen për dijeni edhe përfaqësuesve të palëve të interesuara nga publiku.

Pas zhvillimit të seancës dëgjimore gjatë procesit legjislativ, stafi i Komisionit përgatit një material përmbledhës me të gjitha rekomandimet e sjella nga palët e interesuara nga publiku. Ky dokument pune lehtëson deputetët gjatë shqyrtimit të projektligjit nen për nen, në Komision. Komisioni mund të vendosë të miratojë ose jo rekomandimet për ndryshime të propozuara nga palët e interesuara. Në çdo rast, në raportin e Komisionit për kalimin e projektligjit për shqyrtim në seancë plenare, evidentohet zhvillimi i seancës dëgjimore dhe pjesëmarrësve në të.

Seancat dëgjimore publike zhvillohen kryesisht në hapësirat e Kuvendit, ku ekziston mundësia më e mirë teknike dhe logjistike për t'i realizuar ato. Por, ato mund të mbahen edhe në hapësira jashtë ndërtesës së Kuvendit, me qëllim që qytetarët të kenë më të lehtë pjesëmarrjen, në rastet kur është e nevojshme prezenca e një grupi të caktuar prej tyre. Edhe në rastet kur seancat dëgjimore zhvillohen jashtë ndërtesës së Kuvendit, stafi i Komisionit kujdeset për mbajtjen e procesverbalit dhe krijimin e kushteve për zhvillimin e saj.

Komisionet mund të zhvillojnë seanca dëgjimore publike të përbashkëta, sipas rregullave të përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit, për mbledhjet e përbashkëta të komisioneve.

Pas zhvillimit të seancës dëgjimore një lajm i përmbledhur për zhvillimin e saj publikohet në faqen zyrtare të internetit të Kuvendit.

■ Shprehja e interesit nga palët e interesuara të publikut për pjesëmarrje në seancat dëgjimore të komisioneve

Komisionet parlamentare janë ura lidhëse mes publikut dhe Kuvendit. Ato janë forume të afta të lehtësojnë shkëmbimin e informacionit për një çështje të caktuar, në një fushë të caktuar. Numri i vogël i deputetëve që i përbëjnë ato, (krahasuar me numrin e përgjithshëm të deputetëve të Kuvendit), përbërja me deputetë kryesisht sipas eksperiencës politike ose profesioneve që lidhen me fushën e përgjegjësisë së Komisionit, lehtëson zhvillimin e dialogut mes palëve të interesuara nga publiku dhe Kuvendit. Kompetenca e komisioneve të përhershme për të zhvilluar seanca dëgjimore publike është një kanal i drejtpërdrejtë komunikimi me publikun. Për të gjitha këto arsye, seancat dëgjimore publike janë një mekanizëm i rëndësishëm dhe efikas për palët e interesuara të publikut për të shprehur mendimet e tyre për çështje të caktuara apo për një projektligj. Gjithashtu, palët e interesuara e kryesisht organizatat e shoqërisë civile, mund të shfrytëzojnë seancën dëgjimore si një mundësi promovimi të aktiviteteve të tyre edhe për komunitetin, pasi në mbledhjet e komisioneve mediat janë përherë të pranishme.

Kalendarët e punimeve të komisioneve të përhershme publikohen në faqen e internetit të Kuvendit. Ky është një moment i rëndësishëm kur palët e interesuara njihen me çështjet që do trajtojë Komisioni gjatë tri javëve në vijim. Nëse palët e interesuara vërejnë se Komisioni do të zhvillojë një seancë dëgjimore publike me rëndësi për ta, atëherë ato mund të shprehin interesin për të marrë pjesë në këtë seancë dëgjimore.

Shprehja e interesit për pjesëmarrje duhet të paraqitet në formën e një kërkesë me shkrim. Adresa postare e Kuvendit të Shqipërisë është mjaft e thjeshtë dhe e njohur nga publiku. Nëse koha nuk e mundëson përdorimin e postës, atëherë palët e interesuara mund të përdorin postën elektronike. Në faqen zyrtare të internetit të Kuvendit gjenden lehtësisht adresat e postës elektronike të sekretarive të komisioneve të përhershme parlamentare.

Kërkesa për pjesëmarrje, duhet të përmbajë:

-një prezantim të organizatës së shoqërisë civile, grupit të interesit apo grupimit të interesuar. Në rastin e OJF-ve duhet të përmenden edhe të dhëna të aktit të regjistrimit sipas legjislacionit në fuqi për OJF-të;

- çështjen për të cilën kërkohet pjesëmarrja sipas kalendarit të punimeve të Komisionit të përhershëm;

- arsyet pse kërkohet pjesëmarrja;

- emrat e personave që do të përfaqësojnë palën e interesuar, adresën e saktë dhe kontaktet e tyre;

- materiale të tjera shtesë në funksion të paraqitjes së arsyeve për pjesëmarrje, nëse palët e interesuara e shohin të nevojshme.

Për të lehtësuar këtë mënyrë komunikimi, në anekset e këtij manuali gjendet formulari i nevojshëm për t'u plotësuar, për këtë rast.

Kërkesa, e cila i drejtohet Kryetarit të Komisionit të përhershëm, duhet të jetë e paraqitur qartë dhe e arsyetuar mirë që të mund të arrijë qëllimin e synuar. Përgjithësisht, seancat dëgjimore publike kanë një kohëzgjatje të limituar dhe komisionet përpiqen të përzgjedhin ato palë të interesuara që arrijnë të shprehin më qartë problematikat e çështjeve të caktuara, ose që janë të mirënjohura në aktivitetin që zhvillojnë.

Në rast se seanca dëgjimore zhvillohet gjatë shqyrtimit të një projektligji, atëherë palët e interesuara mund të paraqesin në kërkesën për pjesëmarrje edhe rekomandimet e tyre për ndryshime

në projektligj.

Pas marrjes së kërkesës për pjesëmarrje, Kryesia e Komisionit vendos nëse do të zgjerojë listën e të ftuarve të palëve të interesuara nga publiku, apo jo. Për seancat dëgjimore gjatë shqyrtimit të një projektligji, Kryesia e Komisionit mund të vendosë që të mos e ftojë palën e interesuar të marrë pjesë në seancën dëgjimore, por që rekomandimet e paraqitura prej saj t'i paraqiten Komisionit, gjatë shqyrtimit nen për nen të projektligjit. Në çdo rast, pala e interesuar që ka paraqitur kërkesën njoftohet nga stafi i Komisionit (*shih paragrafin për njoftimin e palëve për seancat dëgjimore në komisione*).

■ Shprehja e interesit nga palët e interesuara për zhvillimin e seancave dëgjimore nga komisionet e përhershme

Për shprehjen e interesit për zhvillimin e një seance dëgjimore publike veprohet në të njëjtën mënyrë si për shprehjen e interesit për të marrë pjesë në një seancë dëgjimore publike. Palët e interesuara mund të propozojnë zhvillimin e seancave dëgjimore për kontrollin e zbatimit të legjislacionit. Palët e interesuara të publikut duhet të bëjnë kujdes në përzgjedhjen e temës që kërkojnë të diskutohet. Ajo duhet të jetë një temë që prek problematika aktuale të zbatimit të ligjit apo çështje konkrete brenda fushës së përgjegjësisë së Komisionit dhe mundësisht të mos jetë trajtuar në një kohë të afërt nga po i njëjti Komision. Palët e interesuara duhet të kenë parasysh edhe kohën në të cilën kërkojnë të zhvillohet seanca dëgjimore. Ajo, për shembull, mund të jetë pranë një dite kombëtare ose ndërkombëtare, apo në një kohë kur Komisioni është më pak i ngarkuar me funksionin ligjvënës.

Mbetet në vendimmarrjen e Komisionit përcaktimi përfundimtar i çështjes që do të shqyrtohet, data, ora, dhe lista e të ftuarve.

Për të arritur qëllimin e tyre për të marrë pjesë në një seancë dëgjimore publike ose për të propozuar organizimin e një të tilla në një Komision, palët e interesuara janë të inkurajuara të kontaktojnë me deputetët e Kuvendit, sipas zonave elektorale që ata përfaqësojnë, Kryetarë komisionesh ose anëtarë të tyre, duke bërë takime të herëpashershme me ta, ku të prezantojnë aktivitetet e tyre dhe të promovojnë punën e bërë apo edhe shqetësimet për një çështje të caktuar. Gjithashtu, ato mund të mbajnë kontakte të vazhdueshme me koordinatorin për shoqërinë civile në Kuvend, si dhe me stafet e komisioneve, duke sjellë herë pas here materiale informuese për aktivitetin e tyre, ose duke sjellë kopje të studimeve apo të raporteve për çështje të caktuara, që janë brenda fushës së përgjegjësisë së Komisionit. Organizatat e shoqërisë civile duhet të mbajnë në konsideratë që të bashkëpunojnë edhe me organizata të tjera, pasi kjo mund të jetë më efektive. Palët e interesuara janë të inkurajuara të konsultohen sa më shpesh me faqen e internetit të Kuvendit, pasi projektligjet publikohen aty, shumë më herët nga shqyrtimi i tyre në komisione dhe kështu fitojnë kohë të vlefshme për të planifikuar hapat që do të ndjekin për t'u përfshirë në vendimmarrjen e Kuvendit në procesin legjislativ.

■ Njoftimi i palëve për seancat dëgjimore në komisione

Në përgatitjen e seancës dëgjimore publike, kryetari, në bashkëpunim me zëvendëskryetarin dhe sekretarin e komisionit, paraprakisht:

-përcaktojnë organizatat e shoqërisë civile, ekspertët, grupet e interesit ose grupimet e interesuara që kanë lidhje dhe interes për projektaktin që do të shqyrtohet, dhe të cilave do t'u dërgohet ftesa/njoftimi për pjesëmarrje në seancë dëgjimore;

-vendosin për çështjet që do të trajtohen gjatë seancës dëgjimore, për informacionin që do të kërkohet dhe pyetjet që mund t'u drejtohen përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe grupeve të interesit, si dhe afatet e dorëzimit të rekomandimeve/propozimeve në lidhje me projektaktin;

-në bazë të kalendarit të punës të komisionit, vendosin datën dhe orën kur do të zhvillohet seanca dëgjimore.

Njoftimi paraprak

Pas përcaktimit të çështjeve të renditura mësipër, stafi i komisionit u dërgon pakëve të interesuara (të përcaktuara nga kryesia e komisionit) njoftimin paraprak zyrtar për të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes së caktuar ose në procesin e konsultimit të projektaktit të propozuar.

Njoftimi mund të kryhet në një apo disa nga format e mëposhtme:

- a) me postë elektronike;
- b) me telefon, faks, ose nëpërmjet shërbimit postar kur njoftimi nuk mund të bëhet me mënyrë tjetër.

Njoftimi duhet të përmbajë:

- a) arsyet përse është konsideruar e nevojshme pjesëmarrja e shoqërisë civile në procesin e diskutimit të projektaktit;
- b) afatin, dhe mënyrën me të cilën palët e interesuara paraqesin ose dërgojnë rekomandimet e tyre;
- c) adresën e personit të kontaktit për mbledhjen e rekomandimeve e të komenteve për projektaktin;
- ç) vendin, datën dhe orën e organizimit të seancës dëgjimore;
- d) një kopje të projektaktit që do të shqyrtohet;
- e) minutazhin që kanë palët për t'u shprehur.

Njëkohësisht me njoftimin që u dërgohet palëve të interesuara, në faqen zyrtare të internetit të Kuvendit bëhet publikimi i njoftimit për organizimin e seancës dëgjimore.

Nëse një nga palët e interesuara nuk ka mundësi që të paraqitet në seancën dëgjimore, njofton stafin e komisionit, duke sqaruar dhe arsyet e mospjesëmarrjes. Në çdo rast, materiali me shkrim që ka paraqitur kjo palë do të jetë pjesë e diskutimit në seancën dëgjimore.

Seancat dëgjimore dokumentohen me procesverbal i cili është dokument parlamentar, si dhe zhvillohen në prani të medieeve.

■ Paraqitja e rekomandimeve nga shoqëria civile

Shoqëria civile me anë të rekomandimeve të saj, mund të marrë pjesë në procesin legjislativ në këto faza:

- Gjatë fazës së draftimit/hartimit të një projektligji. Organizatat e shoqërisë civile mund të thirren të japin opinionet e tyre paraprakisht për një nismë ligjore që deputetët vendosin të ndërmarrin, me ftesë të këtyre të fundit.
- Gjatë seancave dëgjimore, të cilat siç u përmendën më sipër zhvillohen nga komisionet parlamentare për të tërhequr ekspertizën dhe informacionin në lidhje me një fushë të caktuar.

Përfaqësuesit e shoqërisë civile, grupeve të interesit ose grupimeve të interesuara mund të kontaktojnë me deputetët, të diskutojnë me ta për shqetësimet për çështje të caktuara, pasi deputeti mund të ushtrojë të drejtën për të paraqitur nisma ligjore që ata mendojnë se janë me interes publik.

Rekomandimet dhe kontributi i palëve të interesuara për projektligje që janë duke u diskutuar në komisionet parlamentare, do të merren në konsideratë nëse do të dorëzohen brenda 10 ditësh nga data kur drafti i projektligjit është publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit, ose pas kërkesës së shprehur të Kuvendit.

Ky afat mund të reduktohet në raste urgjence, ose kur palët e interesuara shprehen të gatshme të paraqesin rekomandimet e tyre më shpejt. Gjithsesi, dorëzimit i rekomandimeve me shkrim, nëse ka të tilla, nga palët e interesuara, do të bëhet jo më vonë se 3 ditë para zhvillimit të seancës dëgjimore.

Afati i vendosur mund të zgjatet:

- për shkak të natyrës së veçantë të projektligjit që diskutohet (kompleksiteti i temës që është hedhur për diskutim publik, diversiteti i grupeve të shoqërisë civile që kanë shprehur interes etj.).
- në rastet kur përkon me periudhën e pushimeve të deputetëve.

Konfirmimi për marrjen e rekomandimeve të organizatave të shoqërisë civile, duhet të bëhet nga stafi i komisionit, me një përgjigje (me e-mail) ose me mjete të tjera, siç është rënë dakord paraprakisht.

Me përfundimin e afatit për paraqitjen e rekomandimeve, komisioni mbyll procesin e konsultimit për projektligjin në fjalë dhe vazhdon shqyrtimin e tij në fazat e tjera të procesit legjislativ. Palët e interesuara, të cilat kanë paraqitur rekomandime, duhet të njoftohen për datën e zhvillimit të diskutimit të projektligjit në komisionin/komisionet përkatës/e të paktën 5 ditë para zhvillimit të mbledhjes, si dhe të ftohen për të qenë të pranishme.

■ Informimi i shoqërisë civile për rekomandimet e bëra

Stafi i Komisionit përpunon rekomandimet e paraqitura, duke i kategorizuar propozimet në ato që kanë të bëjnë me thelbin e çështjeve që trajtohen (*substantive*), dhe në propozime teknike që kanë të bëjnë më shumë me aspekte të gjuhës, apo me rregullime të tekstit.

Në përfundim përgatitet një material pune ku përfshihen të gjitha rekomandimet, i cili u dërgohet anëtarëve të komisionit përgjegjës, dhe për dijeni dhe Kryetarit të Komisionit për dhënie mendimi si dhe relatorit/relatorëve të këtij Komisioni për çështjen në fjalë.

Gjatë shqyrtimit nen për nen të projektligjit, Komisioni mban parasysh edhe materialin me rekomandimet e shoqërisë civile dhe me shumicë votash, vendos për qëndrimin që do të mbajë në lidhje me rekomandimet në fjalë.

Në rastet kur vendoset që rekomandimet e paraqitura të mos merren parasysh (plotësisht apo pjesërisht), Komisioni duhet të argumentohen arsyet përse është mbajtur një qëndrim i tillë.

Vendimi i Komisionit u bëhet i ditur përfaqësuesve të palëve të interesuara që kanë paraqitur rekomandimet.

Në raportin përfundimtar të Komisionit mbi projektligjin duhet të përshihet dhe një përmbledhje e rekomandimeve të shoqërisë civile që janë marrë në konsideratë.

■ Aktivizimi i specialistëve të jashtëm

Në sistemin tonë të qeverisjes, Kuvendi është organi ligjvënës, pra është ai organi që shqyrton dhe miraton projektligjet. Veprimtaria parlamentare e deputetëve mbështetet nga një administratë efiçente dhe cilësore, por megjithatë, ajo nuk ka kapacitete të mjaftueshme për të mbuluar të gjitha fushat apo çështjet që duhet të shqyrtojë dhe miratojë Kuvendi dhe njëkohësisht të ofrojë ekspertizë në çështje që mund të jenë specifike apo teknike. Për këtë arsye në buxhetin vjetor të Kuvendit caktohet një fond i veçantë që shërben për të angazhuar specialistë të jashtëm, të cilët vihen në shërbim të deputetëve duke u ofruar atyre informacionet, analizat dhe rekomandimet që u nevojiten për të marrë vendimet e duhura. Rregullorja e Kuvendit përcakton se Komisionet ose Këshillat, për realizimin e detyrave të tyre, mund të aktivizojnë specialistë të fushave të ndryshme, në përputhje me vendimin e Byrosë së Kuvendit.

Aktivizimi i specialistëve të fushave të ndryshme synon në marrjen e një ekspertize profesionale dhe të pavarur. Vendimmarrja e mbështetur në një ekspertizë të tillë është më e besueshme, më efektive, më e pranueshme nga publiku dhe për rrjedhojë do të gëzojë një shkallë më të lartë zbatueshmërie.

Pjesa më e madhe dhe më e rëndësishme e punës së Kuvendit, zhvillohet në Komisionet e përhershme parlamentare, të cilat shqyrtojnë sipas përkatësisë projektligjet, projektvendimet dhe çështjet e tjera që paraqiten në Kuvend, kryejnë studime për efektivitetin e ligjeve në fuqi, ndjekin zbatimin e ligjeve dhe kontrollojnë veprimtarinë e ministrive dhe të organeve të tjera qendrore, duke i propozuar Kuvendit ose Këshillit të Ministrave marrjen e masave përkatëse, si dhe propozojnë për miratim në Kuvend projektligje, projektdeklarata ose projektrezoluta.

Në përbërje të komisioneve të përhershme, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve, mund të ngrihen edhe nënkomisione për probleme të veçanta.

Kuvendi mund të vendosë krijimin e një Komisioni të posaçëm për shqyrtimin dhe përgatitjen e nismave ligjvënëse, si dhe për çështje të një rëndësie të veçantë. Kuvendi ka në përbërjen e tij edhe Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin dhe Këshillin për Legjislacionin.

Komisionet dhe Këshillat e Kuvendit, gjatë shqyrtimit të çështjeve, mbështeten në aspektin teknik dhe profesional, nga Shërbimet Legjislative dhe Shërbimi i Kërkimit shkencor, Bibliotekës dhe Arkivit. Nga raportet vjetore të Shërbimeve Legjislative të Kuvendit ka rezultuar se me gjithë burimet dhe kapacitetet shumë më të gjera që ekzekutivi ka në dispozicion, gjatë shqyrtimit të projektligjeve në komisione, bëhen ndryshime dhe plotësime të shumta në drejtim të elementeve të përmbajtjes dhe të teknikës legjislative.

Duke konsideruar edhe numrin e madh të projektligjeve që shqyrtohen dhe miratohen në Kuvend vetëm gjatë një sesioni parlamentar, del si domosdoshmëri shfrytëzimi i burimeve të jashtme të ekspertizës.

Stafet e Komisioneve të përhershme parlamentare krijojnë bazën e të dhënave për ekspertët, e cila përditësohet në vazhdimësi. Ekspertë mund të jenë emra të njohur të jetës akademike në vend, ekspertë të pavarur të fushave të ndryshme, të cilët janë të specializuar jashtë vendit, që ofrojnë ekspertizë për komisionet parlamentare. Kjo bazë të dhënash mund të shfrytëzohet edhe nga këshillat e Kuvendit.

Në rast se gjatë kryerjes së funksioneve të tij, në varësi të rëndësisë dhe kompleksitetit të çështjes që shqyrtohet, Komisioni ose Këshilli konstaton nevojën për ekspertizë shtesë, përveç asaj të ofruar nga administrata e Kuvendit apo specialistët e ekzekutivit, sipas përcaktimeve në Rregulloren e Kuvendit, ai vendos me votim të hapur për aktivizimin e specialistëve të jashtëm, çështjen për të cilën kërkohet ekspertiza, kriteret që duhet të plotësohen si dhe detyrat që do të kryejë specialisti. Pas

marrjes së këtij vendimi, Komisioni ose Këshilli i drejtohet me kërkesë Byrosë së Kuvendit. Në këtë kërkesë parashtrihen arsyet e nevojës së aktivizimit të specialistit të jashtëm, detyrat që do të kryhen prej tij dhe kohëzgjatja e aktivizimit. Byroja vendos për buxhetin e Kuvendit dhe kujdeset për administrimin e veprimtarisë së Kuvendit, në përputhje me buxhetin e tij. Nën dritën e kësaj kompetence, Byroja e Kuvendit shqyrton mundësitë financiare të Kuvendit për aktivizimin e kërkuar të specialistit të jashtëm dhe shprehet me vendim. Në mbledhjen e Byrosë për shqyrtimin e kërkesës merr pjesë edhe Kryetari i Komisionit ose i Këshillit që ka paraqitur kërkesën (kuptohet pa të drejtë vote). Në rast se vendimi i Byrosë është pozitiv, ai përmban kohëzgjatjen e aktivizimit të specialistit si dhe pagesën në total për punën që do të kryhet nga specialisti. Më pas, Komisioni ose Këshilli vijon me përzgjedhjen e specialistit ose specialistëve. Komisioni ose Këshilli mund të konsultohet me bazën e të dhënave për ekspertët të krijuar nga stafi i Komisionit, ose mund të vendosë mbi bazën e propozimeve të deputetëve anëtarë të tij. Në çdo rast vendimi merret me votim të hapur për tre specialistë për çdo pozicion. Në rast se koha për përzgjedhjen e specialistit/specialistëve është e mjaftueshme, Komisioni ose Këshilli mund të publikojë një njoftim për paraqitje interesi për ekspert në faqen zyrtare të internetit të Kuvendit. Në këtë njoftim përcaktohen çështja për të cilën kërkohet ekspertiza, kriteret që duhet të plotësohen si dhe detyrat që do të kryejë specialisti/specialistët, afati brenda të cilit duhet të dërgohet aplikimi. Komisioni ose Këshilli vendos me votim të hapur për përzgjedhjen e listës së specialistëve. Pas përzgjedhjes së listës së specialistëve, Komisioni ose Këshilli i paraqet ofertën me shkrim (për lehtësi veprimi me e-mail) specialistit/specialistëve të përzgjedhur. Nëse për çfarëdo arsye, i përzgjedhuri i parë nuk pranon ofertën e Komisionit ose Këshillit, atëherë Komisioni ose Këshilli kontakton të përzgjedhurin e dytë të listës, e kështu deri tek i treti i listës së të përzgjedhurve për çdo pozicion. Në rast se asnjë nga të përzgjedhurit nuk pranon, atëherë Komisioni ose Këshilli përsërit procedurën e përzgjedhjes.

Nëse eksperti pranon përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive dhe aspektet e tjera që lidhen me ofrimin e ekspertizës së tij pranë Komisionit ose Këshillit, atëherë nënshkruhet një kontratë bashkëpunimi mes Kuvendit, të përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm dhe specialistit. Një kopje e kësaj kontrate i dërgohet Komisionit ose Këshillit, një kopje i dërgohet Shërbimit të Financës dhe Buxhetit dhe një kopje specialistit. Specialistit të jashtëm i vihen në dispozicion nga stafi i Komisionit, të gjitha materialet e nevojshme për të cilat kërkohet ekspertiza. Specialisti mund të mos jetë i detyruar të marrë pjesë në mbledhjet e Komisionit ose Këshillit, por nëse është e nevojshme, atij i krijohen kushtet për të marrë pjesë në to. Specialisti duhet të përfundojë ekspertizën në afatin e përcaktuar dhe ia dorëzon atë Komisionit ose Këshillit. Pas dorëzimit dhe prezantimit të ekspertizës në Komision ose Këshill, Kryetari i Komisionit ose Këshillit, në emër të Komisionit ose Këshillit, lëshon një letër konfirmuese për Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit, përmes së cilës vërteton se specialisti/specialistët ka përmbushur detyrimet e përcaktuara në vendimin e Komisionit ose Këshillit. Letrës konfirmuese i bashkëngjitet dokumenti final i ekspertizës së dorëzuar në Komision ose Këshill. Në rast se specialisti ka marrë pjesë në mbledhjet e Komisionit ose Këshillit, sekretarja e Komisionit vërteton prezencën e tij në mbledhje nëpërmjet nënshkrimit prej saj dhe specialistit, të një listëprezence me datën e mbledhjes. Kjo listëprezencë i bashkëlidhet letrës konfirmuese. Pas marrjes në dorëzim të dokumentacionit të mësipërm dhe vendimit të Byrosë së Kuvendit, Shërbimi i Financës dhe Buxhetit bën pagesën për specialistin, sipas legjislacionit në fuqi.

Kuvendi i Shqipërisë, gjatë veprimtarisë së tij, është mbështetur vazhdimisht nga organizata ndërkombëtare të cilat janë angazhuar për ngritjen e kapaciteteve, për analizimin dhe shqyrtimin e projektligjeve, për realizimin e studimeve, broshurave, etj. Meqenëse, buxheti që Kuvendi ka në dispozicion për të angazhuar specialistë të jashtëm është i kufizuar, bashkëfinancimi me organizata ndërkombëtare ose kombëtare ose financimi i plotë prej tyre, brenda kufijve të lejuar nga legjislacioni në fuqi, mund të jetë një mundësi e mirë. Kuvendi nënshkruan memorandume bashkëpunimi ku përcaktohet mbështetja konkrete që do t'i ofrohet komisioneve ose këshillave për angazhimin e specialistëve të jashtëm, nga organizatat kombëtare apo ndërkombëtare.

■ Pjesëmarrja e publikut në komisionet e përhershme

Mbledhjet e Komisioneve të përhershme të Kuvendit janë të hapura për publikun, me përjashtim të rasteve kur për shkak të natyrës së projektakteve që diskutohen, vendoset që ato të zhvillohen të mbyllura. Mbledhjet për rishikimin e Kushtetutës dhe seancat dëgjimore bëhen të hapura për median dhe publikun.

Personat, ose grupet e interesuara, i paraqesin, të paktën 5 ditë përpara datës së mbledhjes, një kërkesë Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit, në formë të shkruar. Kërkesa dërgohet në adresën postare të Kuvendit ose në adresën e postës elektronike të Sekretarit të Përgjithshëm, dhe duhet të përmbajë datën dhe mbledhjen e komisionit ku kërkohet që të merret pjesë, të dhënat e personit që paraqet kërkesën, si dhe një adresë ose numër kontakti të tij. Formulari i kërkesës është i disponueshëm në faqen zyrtare të internetit të Kuvendit.

Në vlerësimin e kërkesës Sekretari i Përgjithshëm, në bashkëpunim me shërbimet e Kuvendit, mban parasysh kapacitetin e sallës së komisionit në mbledhjen e tij kërkohet pjesëmarrja. Në rast se për atë mbledhje janë paraqitur shumë kërkesa për pjesëmarrje, Sekretari i përgjithshëm vlerëson sipas radhës së paraqitjes, kërkesat që janë paraqitur më të parat. Pas këtij vlerësimi njoftohet personi kërkues. Ngarkohet Shërbimi i Marrëdhënieve me Publikun për të kryer veprimet e nevojshme.

Për të lehtësuar këtë mënyrë komunikimi, në anekset e këtij manuali gjendet formulari i nevojshëm për t'u plotësuar, për këtë rast.

■ Pjesëmarrja e publikut në seancë plenare

Seancat plenare janë të hapura për publikun, me përjashtim të rastit të përcaktuar në Rregulloren e Kuvendit. Mbledhjet për rishikimin e Kushtetutës dhe seancat dëgjimore bëhen gjithmonë të hapura për median dhe publikun.

Personat, ose grupet e interesuara, i paraqesin, të paktën 7 ditë përpara datës së seancës plenare, një kërkesë Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit, në formë të shkruar. Kërkesa dërgohet në adresën postare të Kuvendit ose në adresën e postës elektronike të Sekretarit të Përgjithshëm, dhe duhet të përmbajë datën e seancës në të cilën kërkohet që të merret pjesë, të dhënat e personit që paraqet kërkesën, si dhe një adresë ose numër kontakti të tij. Formulari i kërkesë është i disponueshëm në faqen zyrtare të internetit të Kuvendit.

Në vlerësimin e kërkesës Sekretari i Përgjithshëm, në bashkëpunim me shërbimet e Kuvendit, mban parasysh kapacitetin e sallës së seancës plenare, si dhe numrin e të ftuarve nga delegacionet ose të ftuar të tjerë. Në rast se për atë seancë plenare janë paraqitur shumë kërkesa për pjesëmarrje, Sekretari i Përgjithshëm vlerëson sipas radhës së paraqitjes, kërkesat që janë paraqitur më të parat. Pas këtij vlerësimi njoftohet personi kërkues. Ngarkohet Shërbimi i Marrëdhënieve me Publikun për të kryer veprimet e nevojshme.

Për të lehtësuar këtë mënyrë komunikimi, në anekset e këtij manuali gjendet formulari i nevojshëm për t'u plotësuar, për këtë rast.

■ Paraqitja e peticioneve dhe shqyrtimi i tyre

Peticionet, sipas përcaktimit të Rregullores së Kuvendit, janë ato dokumente të nënshkuara nga një grup individësh të cilët i kërkojnë Kuvendit të kryejë një aksion të caktuar.

Neni 104 i rregullores së Kuvendit përcakton procedurat për peticionet drejtuar Kuvendit të Shqipërisë si më poshtë.

1. Peticionet, të cilat i drejtohen Kuvendit, shqyrtohen nga komisionet e përhershme përkatëse.

2. Pranohen për shqyrtim peticionet, të cilat janë bërë me shkrim, kanë emrin e dërguesit dhe nënshkrimet përkatëse, janë të kuptueshme dhe tregojnë qartë objektin e tyre.

3. Peticionet dërgohen nga Kryetari i Kuvendit në komisionin e përhershëm që ka lidhje me objektin e paraqitur në peticion. Kryetari i komisionit mund t'ia kthejë peticionin dërguesve për rihartim ose t'u kërkojë atyre sqarime shtesë.

4. Jo më vonë se 45 ditë nga data e marrjes së peticionit, kryetari i komisionit e paraqet peticionin në komision, duke propozuar njëkohësisht edhe mënyrën e zgjidhjes ligjore ose mospranimin e peticionit. Në rast se komisioni e gjykon të arsyeshme për zgjidhjen e çështjes, mund të autorizojë kryetarin e komisionit për të paraqitur një deklaratë në seancën plenare të Kuvendit. Hapat e ndërmarrë dhe zgjidhja e çështjes së ngritur në peticion i njoftohen dërguesve të peticionit.

■ Akses i publikut në arkivin e Kuvendit

Në funksion të transparencës së veprimtarisë së Kuvendit çdo palë e interesuar ka të drejtë të njohë dokumentacionin parlamentar dhe fondin historik të Kuvendit që ndodhet në Arkivin e Dokumentacionit Parlamentar. Shprehja e interesit për akses në Arkivin e Kuvendit paraqitet në formën e një kërkesë me shkrim. Kërkesa mund të dërgohet në adresën postare të Kuvendit ose në formë elektronike. Formulari i kërkesës është disponueshëm në faqen zyrtare të internetit të Kuvendit. Pala e interesuar ia dërgon kërkesën Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit. Në faqen zyrtare të Kuvendit gjendet adresa e postës elektronike të Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit.

Kërkesa për akses në arkiv, duhet të përmbajë:

- të dhëna të palës së interesuar;
- arsyen e kërkesës;
- kohëzgjatjen;
- dokumentacioni për të cilin kërkohet akses;

Sekretari i Përgjithshëm vendos pranimin ose refuzimin e kërkesës. Nëse jepet autorizimi, pala e interesuar ka akses mbi dokumentacionin që ndodhet në arkiv, me përjashtim të dokumenteve të klasifikuara si sekret shtetëror. Pala e interesuar mund të shfrytëzojë dokumentacionin parlamentar në mjedisin e Kuvendit. Atij i sigurohet një fotokopje e dokumenteve që janë me interes për të.

Për të lehtësuar këtë mënyrë komunikimi, në anekset e këtij manuali gjendet formulari i nevojshëm për t'u plotësuar, për këtë rast.

■ Vizitat nga grupe të organizuara në Kuvend

Çdo grup personash ka të drejtë të vizitojë Kuvendin e Shqipërisë në funksion të njohjes së publikut me mënyrën e funksionimit të Kuvendit. Vizitat organizohen duke respektuar Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë dhe /ose urdhra të brendshëm. Grupi i interesuar ose një përfaqësues i tyre paraqet një kërkesë pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit. Kërkesa paraqitet në formë të shkruar. Ajo dërgohet në adresën postare të Kuvendit ose në adresën e postës elektronike të Sekretarit të Përgjithshëm.

Kërkesa duhet të përmbajë:

- datën;
- orën;
- qëllimin e vizitës;
- numrin e personave;
- të dhëna për vizitorët (ID e secilit).

Sekretari i Përgjithshëm vendos pranimin ose refuzimin e kërkesës. Kërkesa refuzohet në rast të mungesës së të dhënave që ajo duhet të përmbajë. Në rastin e pranimit të kërkesës nga Sekretari i Përgjithshëm ngarkohet Shërbimi i Marrëdhënieve me Publikun për organizimin e mëtejshëm të vizitës. Organizatorët e vizitës duhet të sigurohen që vizita nuk pengon në punën e Kuvendit. Vizita duhet të njoftohet të paktën 1 javë më parë. Grupi i personave drejtohet nga një përfaqësues i Shërbimit të Marrëdhënieve me Publikun dhe një shoqërues sigurie. Grupi nuk mund të ketë më tepër se 50 persona. Vizitat zhvillohen gjatë ditëve të punës nga ora 09:00 – 15:00.

Gjatë zhvillimit të vizitës, duhet të respektohen rregullat e mëposhtme:

- Grupi i vizitorëve shoqërohet nga një punonjës i sigurisë;
- Vizitorët nuk mund të lëvizin lirisht në mjediset e punës së Kuvendit;
- Vizitorët duhet të respektojnë rregullat lidhur me qetësinë.

Vizitat publikohen në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë.

Për të lehtësuar këtë mënyrë komunikimi, në anekset e këtij manuali gjendet formulari i nevojshëm për t'u plotësuar, për këtë rast.

○ **Organizimi i ditës së hapur së Kuvendit**

Dita e hapur për publikun organizohet një herë në vit (çdo 9 Maj).

■ Raporti vjetor për bashkëpunimin me Shoqërinë Civile

Kuvendi i Shqipërisë në bashkëpunim me organizatat dhe përfaqësues të shoqërisë civile publikon një raport vjetor.

Raporti përmban:

- Të dhëna për pjesëmarrjen e shoqërisë civile në procesin ligjvënës;
- Aspekte të përgjithshme dhe të veçanta të bashkëpunimit;

Raporti publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit.

■ **Konferenca vjetore për çështje të bashkëpunimit me Shoqërinë Civile**

Kuvendi i Shqipërisë mban një konferencë vjetore të përbashkët me përfaqësues të shoqërisë civile për çështje të bashkëpunimit strategjik mes tyre. Në Konferencë marrin pjesë përfaqësues të Kuvendit dhe të shoqërisë civile.



KËRKESË PER NDJEKJEN E VEPRIMTARIVE TË KOMISIONEVE PARLAMENTARE

Tiranë më _____

EMËRTIMI I PLOTË I SUBJEKTIT:

(nëse kërkesa vjen në emër të subjektit)

NIPT/KODI FISKAL: JO PO Cilësoje _____

ÇËSHTJA PËR TË CILËN KËRKOHEM PJESËMARRJA:

Komisioni _____ Data _____ Ora _____

ARSYEJA E PJESËMARRJES:

PERSONAT PJESËMARRËS:

(në rastin e listës shumëemërore të shtohen në mënyrë rendore të dhënat për çdo person)

1. Emri _____ Adresa _____

Mbiemri _____ E-Mail _____ Tel _____

Dokument identifikues Pasaportë Kartë Identiteti Numri _____

2. Emri _____ Adresa _____

Mbiemri _____ E-Mail _____ Tel _____

Dokument identifikues Pasaportë Kartë Identiteti Numri _____

Dokumente të tjera:

(opsionale/nëse argumentojnë pjesëmarrjen)

Nënshkrimi: (Emër/Mbiemër/Vula)



FORMULAR REGJISTRIMI NE REGJISTRIN ON-LINE TE OSHC-VE

Tiranë më _____

1. EMËRTIMI I PLOTË I SUBJEKTIT: _____

NIPT: ose **Kodi Fiskal** _____

STATUSI:

Person Fizik Person Juridik

2. FUSHA E VEPRIMTARISË _____

3. KONTAKTE

Administratori: _____

Adresa: _____

Qyteti/Komuna: _____

Nr. Tel: _____

E-Mail: _____

3. TË DHËNAT E PERSONIT TË KONTAKTIT PËR KUVENDIN

Emri _____ **Adresa** _____

Mbiemri _____ **E-Mail** _____ **Tel** _____

Dokument identifikues: Pasaportë Kartë Identiteti

Numri i dokumentit identifikues _____ / Data e lëshimit _____

Nënshkrimi (Emër/Mbiemër/Vula) _____



KËRKESË PËR PJESËMARRJE NË SEANCAT DËGJIMORE TË KOMISIONEVE

Tiranë më _____

EMËRTIMI I PLOTË I SUBJEKTIT: _____

NIPT/KODI FISKAL: JO PO Cilësoje _____

FUSHA E VEPRIMTARISË _____

ÇËSHTJA PËR TË CILËN KËRKOHET PJESËMARRJA: _____

Komisioni _____ Data _____ Ora _____

ARSYEJA E PJESËMARRJES: _____

PERSONAT PJESËMARRËS:

(në rastin e listës shumëemërore të shtohen në mënyrë rendore të dhënat për çdo person)

1. **Emri** _____ **Adresa** _____

Mbiemri _____ **E-Mail** _____ **Tel** _____

Dokument identifikues Pasaportë Kartë Identiteti Numri _____

2. **Emri** _____ **Adresa** _____

Mbiemri _____ **E-Mail** _____ **Tel** _____

Dokument identifikues Pasaportë Kartë Identiteti Numri _____

Dokumente të tjera:

(opsionale/nëse argumentojne pjesëmarrjen)

Nënshkrimi: (Emër/Mbiemër/Vula)

